



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE "BEQIR ÇELA" DURRËS

Nr. 332 prot

Datë 3/09/2024

Lënda: Njoftim lëvizje paralele

Drejtuar: DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMËVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, i ndryshuar "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucionëve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimëve njerëzore, përbërjes së njësive së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Ofruesi publik I AFP-Së, Shkolla profesionale "Beqir Çela", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Mësimdhënës teorik - praktik profesionale në drejtimin Mekanikë – **1 (një) mësues.**
2. Mësimdhënës teorik – praktik profesionale në drejtimin TIK – **1 (një) mësues.**

A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1. Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

